



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

4099
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 13.08.2013

UDHËZIM

Nr. 36, datë 13.08.2013

PËR PROCEDURAT PËR ARSIMIMIN E FËMIJËVE TË NGUJUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

1. Fëmijët e moshës së detyrimit shkollor, që janë të ngjuar, kanë të drejtë të arsimohen në kushtet e tyre të veçanta.
2. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave bashkëpunojnë me organet e qeverisjes vendore për të evidentuar fëmijët e ngjuar.
3. Mësimi me fëmijët e ngjuar zhvillohet tri herë në javë, me 10 orë në javë.
4. Plani mësimor dhe programet lëndore hartohen nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, sipas kurrikulës së arsimit bazë publik dhe miratohen nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.
5. Kur është e mundur, nxënësit grumbullohen në një nga mjediset familjare mësimore më të afërta dhe të mundshme ku ka fëmijë të ngjuar (Më tutje "mjedise mësimore").
6. Në çdo dy mjedise mësimore të arsimit të mesëm të ulët, që janë pranë njëra-tjetrës, jep mësim një mësues i lëndëve shoqërore dhe një mësues i lëndëve natyrore, duke u këmbyer, me qëllim që të mbulohet mësimdhënia në këto dy fusha të nxëni.

7. Nxënësit e ngjuar u përkasin klasave të caktuara të shkollave publike të arsimit bazë.
Këto shkolla caktohen nga DAR//ZA-të përkatëse.
Mësuesit, që japin mësim në këto mjedise mësimore, janë në organikën e këtyre shkollave.
8. Procesi mësimor bazohet kryesisht te programet individuale, të cilat hartohen nga mësuesit përkatës, me porosi të drejtorit të shkollës.
9. Çdo mësues mban një fletore-regjistër dhe të dhënat e saj i hedh, një herë në dy javë, në regjistrin e klasës përkatëse të shkollës.
10. Pas përfundimit të vitit shkollor nxënësit pajisen me dëftesën e klasës përkatëse.
11. DAR/ZA-të sigurojnë shërbimin psiko-social për nxënësit e ngjuar.
12. Pagesa e orëve mësimore për mësuesit bëhet në përputhje me Udhëzimin Nr. 21, datë 23.07.2010 "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar".
13. Procesi mësimor më nxënësit e ngjuar është objekt i inspektimit nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, si dhe i monitorimit nga DAR/ZA-të përkatëse.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe DAR/ZA-të.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR



MYQEREM TAFAJ

